

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga :

Gjyqtare : Rezarta BALLIU (VIGANI)

asistuar prej sekretares gjyqësore Loreta Merepeza, sot datë 11.01.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore kërkesën penale me:

KËRKUES : Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga prokurori Valentin Preçi.

OBJEKTI : Vendosja e sekuestros preventive .

Baza ligjore : Neni 274 e në vijim të K.Pr.Penale .

1. *Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën e prokurorit i cili kërkoi – vendosjen e sekuestros preventive dhe pasi e bisedoi dhe shqyrtoi çështjen në tërësinë e saj,*

V Ë R E N

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tirane, ne date 13.09.2011, ka rregjistruar proçedimin penal, Nr.3728 per vepren penale te “*Korrupsionit pasiv te personave qe ushtrojne funksione publike*” dhe “*Shpërdorimit të detyrës*”, parashikuar nga nenet 259 e 248 të Kodit Penal.

Nga hetimet paraprake, ka rezultuar se;

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, seksioni i Drejtorisë kundër Krimit Financiar, mbi bazën e informacionit marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit të Parave, ka depozituar materialin kallëzues në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësorë Tiranë .

Ky proçedim, eshte regjistruar mbi bazen e informacionit te referimit te ardhur nga Drejtoria e Pergjithshme e Policise, e cila ka administruar dokumente, që bëjnë fjalë per disa zyrtare te Z.R.K.K.P të Qarkut Tiranë, te cilet,duke shfrytëzuar pozitën zyrtare, kane rregjistruar në mënyre te paligjshme, një pronë shtetërore, në favor të shtetaseve F.S e M.J, përfaqësuar me prokurë nga av. Agim Hoxha .

Nga hetimi ka rezultuar se, Drejtori i Zyres Rajonale te Agjensise se Kthimit dhe Kompesimit te Pronave Tirane, ka marre vendimet per kthimin dhe kompesimin e pronave me **numer 261 dt. 28.08.2008 dhe nr. 276 dt. 10.09.2008** ne favor te trashegimtareve ligjore te subjektit të shpronësuar,N.J. Keto vendime jane marre ne kundërshtim me ligjin nr. 9235 dt. 29.07.2004 “Per Kthimin dhe Kompesimin e Prones”, te ndryshuar, VKM Nr. 747, datë 09.11.2006, “Për procedurat e mbledhjes, të përpunimit dhe administrimit të kërkesave të subjekteve të shpronësuar gjatë procesit të njohjes, kthimit apo kompensimit të pronës”, si dhe akteve te tjera nenligjore qe rregullojne veprimtarine e kthimit dhe kompesimit te pronave.

Ne baze te aplikimit Nr. 2392, date 03.05.2010, me date 13.05.2011 eshte bere rregjistrimi ne Z.V.R.P.P.Tirane, i vendimit Nr. 276, date 10.09.2008 te Z.R.K.K.P.Qarkut Tirane, per dy pasurite ne favor te F.S dhe M.Jt ,me siperfaqe 41.555 m 2, Zona Kadastrale 3774 dhe konkretisht:

- A) Pasuria Nr., vol 13, fq 23, siperfaqja 29.670 m2, lloji i pasurise “Pyll”, data e rregjistrimit 13.04.2011.
- B) Pasuria Nr., vol 13, fq 24, siperfaqja 11.885 m2, lloji i pasurise “Pyll”, data e rregjistrimit 13.04.2011.

Pas rregjistrimit te vendimit Nr. 276, date 10.09.2008 te Z.R.K.K.P Qarkut Tirane, per te dy pasurite jane kryer veprime te tjera, si ndarje pasurie dhe tjetërsime tek persona te tjere.

Gjithashtu, eshte kryer edhe rregjistrimi ne Z.V.R.P.P.Tirane, i vendimit Nr. 261, date 28.08.2008 te Z.R.K.K.P Qarkut Tirane, i pasurise me siperfaqe 32.000 m2, Zona Kadastrale 3501, ne favor te subjektit F.S dhe M.J.

Sa me siper, prokuroria kerkoi qe per pasurite e mesiperme te vendoset masa e sekuestros preventive.

Gjykata pasi e shqyrtoi kerkesen prokurorise çmoi se, kjo kerkese eshte e bazuar ne ligj dhe ekzistojne prova te mjaftueshme, se ne këto siperfaqe toke, te cilat dyshohet se kane lidhje me veprat penale per te cilat ka filluar ky procesim, mund te rendojne pasojat e ketyre veprave penale, duke u tjetërsuar, transformuar, transferuar apo shitur.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata në bazë të nenit 274 të K.Pr.Penale,

V E N D O S I

- Pranimin e kërkesës të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si të bazuar në ligj dhe në prova .
- Vendosjen e sekuestros preventive ne pasurine e rregjistruar **ne Zonen Kadastrale Nr. 3774**, prane Z.V.R.P.P-se, Kavaje, rregjistruar sipas vendimit te Z.R.K.K.P te Qarkut Tirane, nr. 276 date 10.09.2008 dhe qe jane konkretisht:
 - I. Pasuria me Nr., vol. 13, fq. 23, me siperfaqe 29670 m 2,

II. Pasuria me Nr., vol. 13, fq. 24, me sipërfaqe 11885 m², si dhe pasurive aktuale të krijuara si rrjedhojë e veprimeve të mëvonshme të kryera mbi këto pasuri.

- Vendosjen e sekuestros preventive në pasurinë e regjistruar **ne Zonen Kadastrale Nr. 3501**, pranë Z.V.R.P.P-se, Kavaje, sipas vendimit të Z.R.K.K.P të Qarkut Tiranë, nr. 261, datë 28.08.2008 si dhe pasurive aktuale të krijuara si rrjedhojë e veprimeve të mëvonshme të kryera mbi këto pasuri.
- Kunder këtij vendimi lejohet ankimi sipas ligjit .
- U shpall sot me datë 11.01.2012 Tiranë.

SEKRETARE

GJYQTARE

Loreta MEREPEZA

Rezarta BALLIU (VIGANI)